

Arlinda Gjata është diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, në vitin 2001 dhe pas përfundimit të studimeve të avancuara post-universitare në të Drejtën Ndërkombëtare dhe Evropiane ka marrë titullin akademik LLM (Masters of Law) nga Universiteti i Amsterdemit, Fakulteti i Drejtësisë, Hollandë.

Që prej mbarimit të studimeve, znj. Gjata ka qenë pjesë e shërbimit të jashtëm, duke pasur detyra të ndryshme në Ministrinë e Punëve të Jashtme në fushën e së drejtës ndërkombëtare dhe asaj evropiane. Gjatë vitit 2004-2005 ka ndjekur dhe përfunduar studimet e kursit të parë të Akademisë Diplomatike të organizuar nga Ministria e Punëve të Jashtme Italiane në bashkëpunim me atë shqiptare. Gjatë shërbimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme, znj. Gjata ka kryer një sërë kualifikimesh në institucione të ndryshme të vendeve anëtare të BE-së në fushën diplomatike. Ajo gjithashtu, ka qenë Këshilltare në Misionin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian për periudhën 2013-2016.

Znj. Gjata ka qenë pedagoge e jashtme në lëndën e të Drejtave të Njeriut, Universiteti Jopublik, Luarasi. Ajo ka qenë anëtare e grupeve të punës në takimet dhe negociatat e Grupit të Përbashkët Konsultativ, Task-Forcë BE-Shqipëri, për çështjet e minoriteteve dhe gjithashtu eksperte e palës shqiptare në Komitetin e Këshillit të Evropës për Minoritetet.

Gjithashtu, znj. Gjata ka qenë eksperte afatshkurtër në kuadër të organizatave si OSBE/ODIHR, Këshilli i Evropës dhe Nisma për Evropën Qëndrore, në fushën e mbrojtjes së të drejtave të minoriteteve dhe monitorimit të zgjedhjeve, ku ka qenë dhe pjesë e misioneve vëzhguese të OSBE/ODIHR.

Që prej vitit 2020, Znj. Gjata është punësuar në Avokaturën e Shtetit në pozicionin e Avokates së Shtetit në Zyrën e Përfaqësimit në Gjykatat e Huaja, Ndërkombëtare dhe në Arbitrazhin Ndërkombëtar, specifikisht sa i përket çështjeve të përfaqësimit të shtetit Shqiptar në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.